



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë, më, 18.03.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

RAPORTIMIN E ENTIT RREGULLATOR TE UJIT (ERRU) MBI VEPRIMTARINË E TIJ PËR VITIN 2018

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, mori në shqyrtim raportin vjetor të veprimtarisë së Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujrave të Ndotura (ERRU) për vitin 2018 në mbledhjet e tij të datave 12 dhe 18 mars 2019.

Të pranishëm në seancën dëgjimore të datës 12.03.2019 për të bërë prezantim e raportit vjetor si dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të deputeteve ishin Kryetari i Komisionit Rregullator Z.Ndriçim Shani si dhe anëtarët Znj.Lindita Molla, Znj.Silvana Simaku, Znj.Fatime Imeraj, Z.Rudolf Papa.

Komisioni caktoi relator për këtë çështje Zotin Arben Pëllumbi.

- ***Baza ligjore***

Bazuar në nenin 31 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura“, i ndryshuar, ERRU, paraqet në Kuvendin e Shqipërisë Raprotin Vjetor të Punës për vitin 2018.

Komisioni përgjegjës bazuar në nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit dhe ia paraqet atë seancës plenare për miratim.

Miratimi i kësaj projektrezolute kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi***

Në përmbushje të një prej detyrave kryesore të tij, atë të kontrollit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë bazuar në nenin 103, pika 2 të Rregullores së Kuvendit organizon seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit vjetor të institucionit të pavarur dhe, në përfundim të diskutimeve, harton një projektrezolutë të vlerësimit të punës së institucionit dhe ia paraqet atë seancës plenare.

Projektrezoluta përfshin vlerësime dhe konstatime lidhur me veprimtarinë e institucionit të pavarur, në rastin konkret të ERRU-së për vitin 2018, si dhe rekomandime të cilat institucioni i pavarur duhet të ketë në konsideratë gjatë ushtrimit të veprimtarisë gjatë vitit 2019.

- ***Diskutimi në komision***

Në paraqitjen e veprimtarisë së ERRU-së për vitin 2018, Kryetari i këtij enti Z.Ndriçim SHANI u ndal në disa çështje të rëndësishme të aktivitetit të ERRU-së si:

- Performanca në sektorin Ujësjiellës - Kanalizime;
- Ndryshimi i tarifave;
- Situata në zbatim të reformës së ujit, si dhe roli i rëndësishëm dhe sfidat e reja që ka ERRU-ja në kuadër të reformës së ujit, si një reformë jetike për sektorin e ujësjiellës – kanalizimeve;
- Përmirësimi i standardeve në sektorin e ujit nëpërmjet instrumenteve rregullatore;
- Licencimi i shoqërive Ujësjiellës – Kanalizime;
- Mbrojtja e konsumatorit.
-

Deputetët shprehën shqetësimet e tyre në lidhje me sektorin dhe kërkuan që ERRU të luaj një rol proaktiv në lidhje me sfidat dhe zhvillimet e këtij sektori në kuadër të reformës së ujit.

Gjithashtu, Komisioni shprehu angazhimin për rritjen e bashkëpunimit me Entin, duke ofruar mbështetjen e tij maksimale.

Ndërkohë që në mbledhjen e datës 18 mars u diskutua dhe draft rezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2018. Deputetët u njohën me draft rezolutën e përgatitur nga relatori i çështjes dhe propozuan edhe disa ndryshime të cilat u përfshinë në draftin e propozuar.

Komisioni, në përfundim të diskutimeve mbi veprimtarinë e ERRU-së për vitin 2018, vlerësoi punën e këtij institucioni në projekt-rezolutën bashkëlidhur këtij raporti dhe vendosi t'ia paraqesë atë për miratim seancës plenare.

Arben PËLLUMBI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar